

Tiranë, më 4 Prill 2019

## DEKLARATË PËR SHTYP

Organizatat e shoqërisë civile që po monitorojnë ecurinë e reformës në drejtësi dhe aktivitetin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), Instituti i Studimeve Politike (ISP) dhe Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, bazuar në rezultatet e deritanishme të procesit të reformës në drejtësi, ndajnë me publikun qëndrimin se:

1. Edhe pse reforma në drejtësi po vijon, ajo ende po zhvillohet me ritme shumë të ngadalta, si përsa i përket procesit të vettingut ashtu edhe ngritjes së institucioneve të reja. Përveç ritmit konstatohet koordinim i pamjaftueshëm ndërinstitucional si dhe në disa elementë ka probleme me nivelin e transparencës.
2. Përsa i përket procesit të vettingut, ndonëse është konsumuar gjysma e mandatit kohor kushtetues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit deri tani ka përfunduar procesi i rivlerësimit vetëm i më pak se 15% të të gjithë trupës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.
3. Procesi i ngritjes së institucioneve të reja, sidomos i Gjykatave të Posaçme dhe i SPAK, ka tejkaluar afatet kohore ligjore sipas të cilave këto institucione duhet të ngriheshin: brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP). Edhe pse kanë kaluar më shumë se 3 muaj nga ngritja e tyre, ende nuk ka informacion në lidhje me koordinimin ndërmjet dy organeve në drejtim të ngritjes së harmonizuar kohore të institucioneve të hetimit dhe gjyqimit për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndërkohë që vlerësimi dhe përzgjedhja e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme është parashikuar të zgjasë rreth 8 javë, aktualisht nuk ka asnjë informacionin mbi emërimin e përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar edhe pse ky proces ka filluar në fund të muajit dhjetor 2018. Vonesat po shoqërohen ndërkohë me mungesë transparence ndaj publikut, për procedurat, afatet dhe përgjegjësitë nga vetë organet e ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji.
4. Organet e vettingut ende nuk kanë trajtuar me përparësi rastet për rivlerësimin kalimtar për gjyqtarët kandidatë për gjykatat e posaçme dhe kandidatët për prokuror për SPAK, ashtu siç edhe disa prej anëtarëve të zgjedhur të KLP (3 anëtarë) nuk kanë ende vendim përfundimtar të konfirmimit në detyrë, pasi vijnë të jenë në pritje të gjyqimit në shkallën e dytë të vettingut.
5. Procesi i zgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm gjithashtu po ecën me ritme të ngadalta ndërkohë që Shqipëria po mbush 15 muaj me Prokuror të Përgjithshëm të Përkohshëm.
6. Shqetësim paraqesin edhe disa vendimmarrje të KLGJ-së dhe KLP-së, të cilat kufizojnë aksesin për informim publik dhe monitorim para dhe gjatë realizimit të mbledhjeve plenare. Si rrjedhim, kjo situatë pamundëson jetësimin e parimit të transparencës, krijon elementë të dyshimit në

integritetin e aktivitetit të institucioneve dhe ndaj mund të cenojë besimin e publikut në rezultatet dhe ecurinë e procesit.

7. KLP nuk ka ende një godinë definitive ku të ushtrojë në mënyrë permanente veprimtarinë e tij, ndërkohë që si KLP dhe KLGJ nuk i është alokuar ende buxheti, nuk janë pajisur me personelin administrativ mbështetës. Kufizimet në buxhet dhe personel kanë bërë që në disa raste, këto institucione të mos respektojnë afatet ligjore të informimit ndaj aktorëve vendas që monitorojnë veprimtarinë e tyre.
8. Së fundmi, ne apelojmë institucionet përgjegjëse, KLGj, KLP si dhe organet e vettingut për transparencë dhe komunikim me publikun duke iu përgjigjur interesimit të tij për ecurinë dhe proceset në drejtim të ngritjes së institucioneve të hetimit dhe gjyqimit për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke hedhur dritë mbi ecurinë e deritanishme për të shmangur politizimin dhe ecjen me hapa të shpejtë të këtyre proceseve. Transparenca dhe komunikimi i qartë, i kohshëm dhe i shpeshtë me publikun kontribuon në një klimë besimi me të mirë dhe adreson pritshmëritë që qytetarët kanë për këtë proces. Gjithashtu, i kërkojmë organeve të vettingut të trajtojnë me përparësi rastet për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve kandidatë për gjykatat e posaçme, kandidatëve për prokuror për SPAK si dhe në tërësi ecjen me ritme më të shpejta të procesit të vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve.